

Thirrje e Hapur për Punë Praktike në Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP)

Platforma CiviKos, në bashkëpunim me [Institutin për Teknologji dhe Shoqëri](#) (ITS) dhe në partneritet me [Agjencia për Informim dhe Privatësi](#) (AIP), hap thirrje për një praktikant/e. Kjo thirrje është në kuadër të projektit "Përmirësimi i Mbrojtjes së të Dhënave dhe Sigurisë Kibernetike në të Gjitha Sektorët në Kosovë" mbështetur përmes programit MATRA, nga [Ambasada Holandeze në Prishtinë](#).

Detajet e Praktikës:

Pozita : Praktikant/e me orar të pjesshëm
Vendosja: Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP)
Kohëzgjatja: 3 muaj

Kriteret për Aplikantët:

Arsimi: Student ose i diplomuar në Shkenca Politike, Siguri ose fusha të ngjashme.
Njohuri: Të njohë punën dhe natyrën e punës së Agjencia për Informim dhe Privatësi.
Disponueshmëria: Të jetë i gatshëm të punojë 4 orë në ditë.
Motivimi: Të jetë i motivuar për të kontribuar dhe punuar me AIP.

Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi.

Për të aplikuar, dërgoni CV-në tuaj dhe letër motivuese (se pse jeni kandidat/e i/e përshtatshëm për këtë pozitë) në info@civikos.net.

Shtyhet afati për aplikim deri më 28 qershor 2024.

Vetëm kandidatët e listës së ngushtë do të ftohen për intervistë.

Kjo praktikë ofron një mundësi unike për të fituar përvojë praktike në mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë kibernetike, duke mbushur hendekun midis njohurive akademike dhe aplikimit në botën reale. Bashkohuni me ne për të kontribuar në punën e rëndësishme të Agjencia për Informim dhe Privatësi.